# DËSHMI ARKIVI

**A-465400**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Vlora ia ka fikur radarët shtetit”, Bardhi: Nëse urdhëroheni nga grupet kriminale, këtu nuk ka më shtet – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/vlora-ia-ka-fikur-radaret-shtetit-bardhi-nese-urdheroheni-nga-grupet-kriminale-ketu-nuk-ka-me-shtet/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 10:00:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 09:55:54 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9438e97c065bc4820acf42eb95f621b9325bde30fb0119ae3c50317dcaa30288` |
| TEKSTI | `e7d45bdd20fad039674b2ccbe1663b4032e6f925134b39894750983c90716571` |
| PAMJA | `cbaed0180a17d09a7df5813e639da7c00d46c625289497606fadd0323beef8b9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e827ff02be6472fef2228e9de0895aeb98a2b16e38ccac2d4ef14e94efe2afd8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `34bf9fb855e0215b8384019a592b192cd8415b3fea3e8d3a2dd71c749e8b79fe` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e827ff02be6472fef2228e9de0895aeb98a2b16e38ccac2d4ef14e94efe2afd8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, e ka cilësuar situatën e krijuar pas arrestimoit të kreut të SHISH si një nga momentet më të vështira për Parlamentin dhe Republikën e Shqipërisë. Në fjalën e tij në seancën plenare, Bardhi ka akuzuar mazhorancën se po përpiqet të shmangë përgjegjësinë politike dhe ka kërkuar praninë e kryeministrit Edi Rama në Kuvend për të dhënë shpjegime.

Bardhi ka përsëritur akuzat e opozitës për emërimin e Vlora Hysenit në krye të SHISH, duke pretenduar se ajo ka vepruar në favor të grupeve kriminale. Ai ka deklaruar se nëse drejtues të institucioneve të sigurisë dhe qeverisë ndikohen apo urdhërohen nga grupe kriminale, atëherë, sipas tij, “nuk ka më shtet”, ndërsa e ka cilësuar situatën si pasojë të asaj që opozita e quan “narkoshtet”.

***Bardhi****: Ky është një nga momentet më të vështira qoftë për Parlamentin, qoftë për Republikën e Shqipërisë. Ju mundoheni që një nga çështjet më të rënda ta trajtoni duke ju mbrojur një e papërgjegjshme. Sot në vitin 2026 Shqipëria vend anëtar i NATO, vend kandidat për BE ….ne ju thamë që Vlora Hyseni është emërim i Ergys Agasit. Na thanë “nuk i bën Edi Rama këto”. Ku e keni Edi Ramën sot? Fshihet pas një të papërgjegjshmeje (ministrja Erjona Ismaili) që nuk di çfarë thotë. Një zyrtar i përgjegjshëm nuk mund të vijë këtu dhe të thotë që ne jemi më të mirët kur shefja e SHISH jo vetëm ndihmonte kreun e një organizate kriminale t’i arratisej drejtësisë, por i thoshte “thuaj çuanve të veprojnë lirshëm sot se unë për ty fik radarët e shtetit”, në fakt ia ka fikur radarët shtetit, ka fikur dhe radarët tuaj. Nëse shefin e shërbimit, drjetorin e përgjithshëm, kryeminsitrin e vendit e urdhërojnë grupet kriminale dhe grupet e trafikut*


4 Ndryshime në drejtimin e Policisë së Shtetit, emërime të reja në disa qarqe

5 “Krejt këta njerëz që na kanë bërë çka na kanë bërë dua që të paguajnë”,…

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

REKLAMË

*të drogës këtu nuk ka më shtet. Ky është narkoshteti që keni ndërtuar ju.*

Më herët, ministrja socialiste Erjona Ismaili, zhvendosi debatin te historia e Shërbimit Informativ Kombëtar dhe periudha e drejtimit të tij nga qeveritë e mëparshme. Ismaili akuzoi  Partinë Demokratike dhe Sali Berishën për mënyrën se si është përdorur SHIK-u gjatë viteve '90, duke rikujtuar episode që, sipas saj, kanë lënë gjurmë në historinë e institucioneve shqiptare.

*"SHISH-i sot është një institucion që prej viteve '90 ka përfaqësuar rënien e shtetit. S'kanë si ta harrojnë shqiptarët SHIK-un, ku ju jeni kujdesur t'i lini memories institucionale fakte, urdhra, histori të shkruara me gjakun e atyre që me jetë vuajtën pushtetin tuaj të pakufishëm mbi çdo lloj pushteti, qofshin dhe të pavarura. SHIK-u i atëhershëm, i të gjithëpushtetshmi Sali Berisha, që përndiqte, përgjonte, vriste, si polici politike dhe që nuk jepte llogari askund. Si mund ta harrojnë shqiptarët SHIK-un?", deklaroi ministrja.*

#GazmentBardhi #Kuvend #vlorahyseni

WRITTEN BY
**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus

Të gjithë artikujt →

## Vazhdo të lexosh



POLITIKË

**Vlora Hyseni mbërrin në GJKKO, pritet t'i...**

Ana Miha 24 Sht 11:59



POLITIKË

**"Shqiptarët nuk e harrojnë SHIK-un e...**

Ana Miha 24 Sht 11:48



POLITIKË

**"Edhe ju si socialistë keni ulur kokën",...**

Xhuljana Zhuleku 24 Sht 11:27

REKLAMË

## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.